

LASHTESIA E BUJQESISE NE TREVAT SHQIPTARE

Dr. Moikom Zeqo

Marre nga Libri "Historia e Bujqesise dhe Agroindustrise Shqiptare"

Antropogjeneza lidhet me punen krijuese te Homo sapiens. Te gjithë historianet e qytetrimëve klasifikojne kalimin nga sistemi i gjuetise ne natyre, qe nenkupton nje nomadizem te perhershëm ne sistemin e kultivimit te tokës , qe lidhet me ngulitjen dhe vendbanimet e para njerezore..

Ky kapercim kopernikan nga gjuetia e njerezve parahistorike ne njohjen e kultivimit te bimeve te natyres, si dhe krijimin e konceptit te vendbanimeve perfaqeson Revolucionin Bujqesor ne zanafillen e tij. Qe nga parahistoria ky revolucion i bujqesise e ben token bujqesore atributin e zhvillimit te jetes, e cila tashme merre nje karakter te veteorganizuar. Ne keto kohra teper te skajshme gjahtaret parahistorike shendrrohen ne bujq parahistorike, ndonse dualizmi i tyre vazhdon dhe nuk mund te zhduket. Sistemi i bujqesise ndryshoj gjithëcka dhe mund te thuhet se fillesat e qytetrimëve lidhen me kete menyre te re jetese dhe pune, madje ne nje kuptim te shumefishte pa perjashtar dhe koherat moderne.

Jane pikrisht te dhenat arkeologjike ato qe na hapin perpara syve boten e paditur dhe te heshtur te parahistorise. Dikur nje arkeolog francez, Leon Rei, shkroi ne fundin e shek. XIX se ne Shqiperi parahistoria eshte nje njolle e bardhe. Eshte merite e arkeologjise shqiptare qe gjate bonifikimit te fushes se Maliqit, shenoj nje prelude te madh.: Zbuloj nje fshat parahistorik kolosal, ku jeta kishte vazhduar poa nderprerje per 1500 vjet.. Ky vendbanim parahistorik i Maliqit kish filluar te banohej rreth viteve 2700 para eres sone dhe vazhdoj sii tille deri ne vitin 1200 para eres sone.

Lashtesia e vendbanimit te Maliqit i coj arkeologet ne gjetje te reja, madje akoma me te lashta si p.sh. ne Dunavec, Vashtmi, Podgori dhe Luadisht. Keshtu u vertetua qe Fusha e Korces eshte banuar qe nga mijevjecari i IV para eres sone nga nje popullsi qendruese, ndenjetare. Keshtu ne epoken e neolitit merr zhvillim kultura materiale e bujqesise.

Lindja e Bujqesise coi ne nje siguri dhe ne rritje mjaft te madhe te popullsesise.

Vertetohet arkeologjikisht se skeletet e banoreve neolitike ne Europe jane 100 here me shume se se skeletet e banoreve paleolitike. Mos te harrojme se epoka e Neolitit ka zgjatur afer 3 000 vjet. . Zbulimi i kultures parahistorike te Korces qe nje ngjarje kolosale shkencore jo vetem ne rrafshin e Shqiperise, por dhe ne ate evropian.

Kronologjia shkencore e bere nga arkeologu Frano Prendi solli nje risi dhe ne konceptin e autoktonise nga me me vjetrit ne Europe te banoreve te Shqiperise. Bujqesia ne kete lak

kohor kishte karakter primitive. Perdoreshin vegla bujqesore te thjeshta me shkopinje ne majat e te cileve kishte gure stralli ose brire dreri.

Kjo lloje bujqesie eshte quajtur bujqesi me shate.

Por bujqit parahistorike te Korces krijuan nje lloje parmende primitive te pajisur me plor prej brinje dreri qe mund ta cante token deri ne thellesine 15 cm.

Ne epoken e bakrit dhe te bronxit filluan te vihen ne perdorim vegla bujqesore metalike, si p.sh, sopatat, shetrit, rremihsit, kazmat dhe sopatat prej bakri dhe bronxi.. Hekuri gjithashtu beri ne revolucion ne cilesine me te larte te veglave bujqesore. Veglat bujqesore prej hekuri gjenden ne takemet e varreve te Matit, qe ne shek. VI p.e.r.

Si pasoje e kesaj teknologjie te re bujqesore do te kemi nje shtim te prodhimit bujqesor, aq sa ne nje nje mbishkrim te shek. IV, p.e.r., thuhet se se fisi ilir i pajoneve arrinte te prodhonte aq grure, sa qe furnizone me shumice dhe qytetin e famshem grek Athinen. Kultura kryesore bujqesore ishte gruri, por kultivoheshin dhe perimet si hudhra, qepa, lakra, prasi, bizellja, batha, qiqrat dhe thierza. Pati nje nje lulezim te larte kultura e hardhive e zhvilluar ne pjergulla. Per gjetjet arkeologjike te epokes arkaike te shek. VIII-VI, p.e.r., jane gjetur shue pitosa, ene te medha qeramike me funksionin e hambareve, qe mbusheshin me prodhime bujqesore ose me vajin e ullirit.. Keto pitosa kane qene rret 1.5 m te larta, me forme sferike dhe mbanin rreth 3 kv drithe.¹

Vetem ne qytezen ilire te Rosujes Tropoje, jane gjetur 20 pitosa te tille, hambare. Ne Muzeun Historik Kombetar eshte vendosur nje pitos i madh nga fshati Tren i Korces, qe ka te grricur figuren e nje parmende prej druri te pajisur me plor hekuri. i takon shekullit IV, p.e.s.. kemi te bejme me paraqitjen grafike te parmendes qe kane perdorur iliret, qe mesa duket ka qene ndertuar prej tyre , si nje fuqi kultike.. Shume pitosa jane gjetur ne Durres, Apolloni, Butrint, Irmaj, Klos, Floq,, Amantia. Madje jane zbuluar dhe pitosa-hambare te gedhendur ne shkemb, ne kodren shkembore ne fshatin Mallkeq te rrethit te Vlores. Krahas pitosave jane gjetur dhe havane guri, apo mokate mullinjeve te lashte, qe shebenin per buarjen e drithit ne miell. Herodoti ben fjale per fushat e Apollonise, ku kishte dhe dele q ii ishinkushtuar kultitte diellitdhe edhe havane guri, apo mokrat ullinjeve te lashte, qe sherbenin per bluarjen e drithit ne miell.²

Sipas nje autori me origjine ilire Marsel Komesi, qe ka jetuar ne shek. E VI ne kohen e Justinianit te Madh, jane pikrisht iliret qe shpiken te paret mullinjte me uje, fakt pak i studiuar, por teper i rendesishem.³

Te dhenat e para per bujqesine tek iliret i japin autoret antike. Keto nisin qe nga Homeri,, Hesiodi, Herodoti, etj. Homeri flet per per Mbretin e e thesproteve, Theidonin, i cili i dha Odiseut nje anie thesprote me grure. Hesiodi ne fragmentin 134 te vepres se tij, "Cermia", shkruan per fushen reth Dodones si "shumepjellore dhe me luadhe te mira e pasur me dele dhe kope dhensh". Te dhena per bujqesine tek iliret jep edhe Herodoti. Herodoti ben fjale per fushat e Apollonise, ku ishte dhe dele qe i shin kushtuar kultit te

¹ Sigurisht kjo eshte njesi e konvertuar nga autori, mbasi tradicionalisht sidomos per njesite e peshes ka patur nje variacion te madh qe nga mashterku, shosha, shiniku, barra etj.

² Besoj se autori nenukton me drithra ato bime qe asokoheperdoreshin pergatitjen e miellit per buke, okra, Triticum monoccocum, tepa, triticum diccocum, dhe me vone do te kemi dhe thekren dhe grurin dhe nenen, Amaranthus sp . Kuptohet qe misri do te vinte shume me vonese. Edhe orizi akoma nuk i eshte bashkangjitur ketij grupi, kultivimi it e cileve destinohej per buke.

³ Pa qene ti shtojme ketij perfundimi te Dr. Moikom Zeqo, mulliri perben padyshim terminalin e gjithe vepreprimave te bujqesise dhe fshatit.

Diellit. Herodoti flet dhe per nje person historik, qytetarin e Apollonise me emrin Eveni, , te cilin bashkeqytetaret e verbuan se gjate ruajtjes se deleve kushtuar Diellit e kishte zene gjumi dhe uqjerit shqyen 60 dele. Mbas verbimit te Evenit delet nuk pillnin dhe toka nuk jepte me fruit si rezultat i mallkimit. Apoloniatet shkuan dhe tek Orakulli i Dodones dhe pyeten se cili ishte shkak i kesaj fatekeqesie. Pergjigja qe se mallkimi mund te hiqej, nese e shperblenin Evenin, qe kishin verbuar pa te drejte.. Atehere apoloniatet e pyeten se cfare shperblimi kerkonte Eveni per te keqen qe ato i kishin bere.. Sipas Herodotit, Eveni kerkoj qe ti jepnin disa nga arat qe ishin me te mirat ne Apolloni, si dhe nje shtepi prane tyre, qe ishte me e mira ne qytet. Apoloniatet ja dhane menjehere keto gjera qe kerkoj Eveni. Mallkimi u hoq dhe Evenit ju dha vetia e Orakullit. Kjo ngjarje eshte e shek. V p.e.s.⁴ Mesojme se ne Apolloni ne kete kohe kishte ara te kultivuara mjeshterisht, madje ne nje monument arkeologjik permendet dhe fusha me emrin Gylakea. Te shumta jane te dhenat per bujqesine dhe blegtorine tek iliret nga Aristoteli. Aristoteli tek libri i tij “De animalum historia (Mbi Historine e kafsheve) flet se ne Iliri ka derra, se lopet e Epirit jane te medha, se qete dhe delet ne Epir quhen pirike, sipas emrit te Mbretit te Pirros i Madh, se kopete arrijne ne qindra krere, se gomeret jane te vegjel, por qe sherbejne shume ne bujqesi. Po Aristoteli thote se se iliret e quajtuar taulante bejne vere nga mjalti, se ne Epir ka drere te medhenje, briiri it e cileve perdoret per te bere shume sende te dobishme, etj. Nje tjetër autor , Skymni, i shek. III p.e.s ne vepren ne vargje : “Pershkrimi i botes”, shkruan se rreth detit Adriatik jetojne afro nje milione gjysem ilire “qe kane toke shume te mire dhe pjellore, ku dhe bagtia pjellin binjake”. Skymni tre tregon dhe per levrimin e tokes nga iliret ⁵. 200 vjet me pas Straboni shkruan shkruan Ilirine se “ ky vend eshte i ngrohte dhe frytedhenes, por dhe plot me ullishte e vreshta te mira”. Perverc grurit, bujqet ilire kultivojne dhe elbin. Prej elbit iliret krijuan nje pije te vecante te quajtur sabaja, nje lloje birre, e cila u be e famshme ne Iliri, kryesisht ne shtresat me te varfera. Ne shek. Te eres sone, lavdrohet shume balisku,nje lloje lrrushi qe rritet ne rrethin e Durresit. Ky lloj rrushi dyrrahas, ka shtegtuar deri ne Marseje te Frances ku eshte kultivuar. ⁶ Nje autor romak Terenc Varoni,i cili ka shkruar vepren “Mbi ekonomine fshatare”, flet per iliret si mjeshttra te bujqesise, si dhe te te korrjeve dhe vjeljeve qe i quan oberrari,⁷ qe ishin me shumice ne provincat ilire. Ne kete veper mesohet se se iliret dasarete, paretinet, qene njerez qe kultivonin shkelqyeshem drithin. Iliret per ti bere me pjellore tokat e tyre ishin nder te paret ne Evrope, qe moren me hapjen e kanaleve dhe me bonifikime mocalore. Ne zonat me bujqesore te antikitetit ishin periferia e Apolonise qe perkon me fushen e Myzeqese. Te 200 kolonistet qe erdhen nga Durresi per te krijuar qytetin e Apolonise ne vitin 558 p.e.s., ishin bujq qe udhehiqeshin nga Gylaku, i cili i dha emrin edhe fushes se Apolonise.

Ekonomia bujqesore do te conte dhe ne krijimin e kulteve dhe te hyjnive qe lidheshin me bujqesine. Vete Gylaku duhet te jete hymnizuar, lidhur me fuqite ktonike te tokes. U perhap sidomos kulti i dy hyjnive mbrojtese te tokes dhe te bujqesise, Demetes dhe Kores. Ne nje faltore te shek III p.e.s., ne Apoloni u gjenden qindra fragmente

⁴ Shprehja para eres se re , p.e.r. eshte zendesuar me “para eres sone”, p.e. s. para eres sone. (I.XH)

⁵ Te gjithë autoret dhe studiuesit pranojne se levrimi, punimi apo qofte dhe gervishtja e tokes shenon lindjen e bujqesise dhe shkeputjen e njerezimit nga te ushqyerit me fruta natyrale apo me gjuetine e kafsheve te egra., mbasi diktuan qe mbirja e farave kerkonte nje shtrat toke te pergatitur..

⁶ Disi e veshtire per indentifikimin taksonomik dhe ampelografik te ketij lloj rrushi qe permendet autori.

⁷ Autori nuk jep spjegime per etimologjine e kesaj fjale.

terrakotash, dhurata votive per hyjnite e sferes bujqesore. Ne monedhat e Durrësit dhe Apolonise gjenden dhe simbolet që lidhen me figurën e parmendes së gurit, rrushit dhe bletës. Një reliev në Apoloni ka të skalitur figurën e një djaloshi me mrin Epikad që mban në dorë një vesh rrushi. Në Durrës dhe Apoloni janë gjetur fruta pemësh të modeluara në balte të pjekur si molle, dardhe, fiq, perdorur si lodra për femije.

Qytetet dhe vendbanimet ilire në shek. V p.e.s. janë të lidhur ngushtesisht me bujqesinë. Disa nga këto qytete të tipit Polis, si Durrësi dhe Apolonia kanë një juridiksion të plote mbi rrethinat apo hinterlandet e tyre që janë kryesisht rurale dhe bujqesore. Përgjithësisht këto hintelände lidhen me popullsinë vendase ilire, kurse Brenda qyteteve Polis, vazhdojnë të mbijetojnë edhe brezat e kolonistëve Dore dhe Korintas, duke krijuar një kulturë mikse me origjinalitet të vecantë. Në shekujt IV-II p.e.s. në Iliri fuqizohen mardheniet skllavopronare në prodhim. Kjo krijoi shtresën e bujqëve skllaver në prodhim. Theopompi shkruan se fisi ilir i Ardineve kishte në vartësi 300 mijë prosperate, që ishin bujq të shpronësuar pa tokë me statusin e skllavit. Po kështu edhe Agathakiditi shkruan se disa perfaqësues të parisë dardane kishin deri 1000 skllaver, të cilët në kohë paqe punonin tokën dhe në kohë lufte merrnin pjesë në ushtri. Bujqit e e kesaj periudhe ndaheshin në dy pjesë, në skllaver drejtë përdrejtë dhe në bujq relativisht të lirë.

Në hartën arkeologjike të rrethit të Skraparit ka afro 60 vendbanime bujqesore. Disa nga këto vendbanime paten dhe fortifikime, por përgjithësisht ishin fshatare. Këtu gjetjet arkeologjike të veglave bujqesore tregojnë se se 90 % e kesaj krahine përbehet nga bujq të lirë dhe jo skllaver.

Bujqesinë ilirët nuk emesuan ngatë tjerët, sic thone disa teza të studiuesve të huaj, të cilët mendojnë se gjoja ilirët qene një popull endacake, që rronin nga ekonomia e kullotave. Të gjitha të dhenat që shkruam me lartë tregojnë se gjeneza e bujqesisë tek ilirët është autoktone dhe jo e importuar. Madje të dhenat parahistorike deri në antikitet tregojnë një vijimesi dhe jo ndërprerje, pavarësisht nga dyndjet e popujve të tjere kalimtare. Kjo vërteton jo vetëm autoktoninë etnike të ilirëve, por edhe autoktoninë e kultures materiale të punës dhe të jetës. Është e marreveshme të mendosh se ndonjë perfaqësues serb si Jovan Svijic, i cili thote që gjoja ilirët e mesuan bujqesinë nga sllavët, kur sllavët erdhën në Ballkan dhe në trojet e Shqipërisë, të pakten nga shekulli VI i erës sonë. Në vitin 168 p.e.s. ilirët pushtohen nga romakët. Është për habitur, por kultura romake e punimit të tokës në këtë periudhë ishte e nivelit më të ulët me të ulte se ajo ilire. Sundimi romak krijoi strukturime të reja. Pomponi Atiku, miku i Ciceronit në vitet 50 p.e.s. zotëronte pronat shume të mëdha bujqesore në periferinë e qytetit Butrint. Fisi i Prasaibeve kaone, ishte shëndërruar në një koloni romake me karakter ushtarak dhe bujqësor. Po kështu u shëndërrua dhe fisi i pirustëve në rrethinat e Lezhës. Romakët sollën disa kolone italice në rrethinat bujqesore të Durrësit, të Tiranës dhe Skampinit. Pronat e mëdha bujqesore u quajtën latifunde. Ato shfrytëzoheshin nga romakët në mënyrën më të tejer dhe të pamshirshme. Kjo çoi në rrenimin e bujqëve ilirë, të cilët u rebeluan dhe sipas burimeve të shkruara romake çilesoheshin latrone, d.m.th. kusare. Rebelimet e latroneve u bene shume shqetësuese për Romën. Dihet nga të gjithë kryengritja e e famshme e Batos ilir në kohën e Oktavian Augustit, që rrezikoi tërë Perandorinë romake

Sipas edicionit të ri të Historisë së Popullit Shqiptar, bujqësia dhe dhe blegtoia e ilirëve, jo vetëm ka ndikuar në vendet fqinje dhe është ndikuar nga ato nëpërmjet tregëtisë dhe rrugëve të tjera.

Nje ndryshim progresiv nga shek. III-IV i eres sone. Institucioni i skllaverise dobesohet dhe lind nje kategori fshatersh te lire, qe me vone u quajten kolone te mesjetes. Nga germimet arkeologjike te kesaj kohe del se zhvillimi bujqesor ne Shqiperine Qendrore shoqerohet me vegla bujqesore me te perparuara. Keto vegla bujqesore jane me te sofistikuara dhe perbejne nje koleksion te mrekullueshem te historise se bujqesise ne Shqiperi. Ne nje monument me mbishkrim, e zbuluar ne fshatin Karbunare jane skalitur disa vegla bujqesore: nje parmende me plor hekuri, nje kazem, nje lese, nje kreher dhe kallu gruri. Te pasura kane qene qene veglat e korrjes. Poeti i shek. V Klaudiani shkruan keshtu: “ Bujku ilir i pertrin me grigen⁸ e tij kosat e nxira nga ndryshku, i bejne te shkelqejne shatat e demtuara nga mos perdorimi, njeh kasollen e tij, puth kodrat e njohura dhe nuk i besohet qe parmenda, te cilen rishtaz ne dore e mori, plisa dheu po nxjerre dhe pasi prët pyjet e formuara, ngaqe toka kish mbetur e papunuar per nje kohe te gjate i rikthen ato ne ara pjellore dhe vreshta”.

Shek. IV i eres se sone perputhet me ate qe quhet “Rilindja e dyte e ilireve”.

Nen lekuren romake te pushtimit, populli ilir merre fryme dhe gjallerohet e dhe synon te forcoje indentitetin e tij. Kjo duket dhe ne zhvillimin e zejtarise dhe te artit te skalitjes te monumenteve, qe me plot gojen quhet art ilir. Gedhendja ne gur ka nje stil me autokton dhe te ndryshem nga arti romak apo ai grek. Ne nje relief te gjetur te gjetur ne Drashovice, ne Vlore eshte figura e e nje gureskalitesi me cekane ne dore e majte.

Ne nje relief te gjetur ne Vlore eshte gedhendur figura e nje bujku si zgjedhe me dy koka qeshe (shumesi i kaut, nje pende qe, I.XH.) per e ta vene ne kulare. Ne nje relief tjetër ne Kurjan te Fierit ka dy figura te fshatareve, njeri ka ne dore nje fyell, tjetri ka nje shkop si dhe nje sopate dytehshe. Ne fshatin Trent te Korces eshte gjetur nje relief, qe eshte vendosur so te ne Muzeun Historik Kombetar, qe perfytyron dy farketare ne punishten e tyre, qe kane ne mes kudhren dhe ne te dy anet kane te varura veglat e punes. Kto reliefe jane dokumenta te pacmuara jo vetem te artit ilir, por dhe te jetes. Tek keto relieve nuk vrehet as idealizmi i artit te vjeter grek, por as natyralizmi i artit romak. Ky art skulpturor ilir nuk pasqyron figura njerezish me pushtet por kryesisht figura fshataresh dhe zejtaresh. Sipas mendimit tim ky art skulpturor ne gur lidhet me nje tradite me te lashte qe ka humbur ne saj te gedhendjes se drurit, ku pergjithesisht relievizimi i figurave nuk eshte shume e thelle, ndersa kompozimi i figurave eshte konvencional.

Zhvillimi i bujqesise ilire coi dhe ne nisma te medha .


E famshme do te mbetet nje nga veprat inxhinierike te shek. III te res sone, sic eshte diga e Krapsit ne luginen e lumit Gjanice ne rrethin e Fierit, ne kufirin lindor te Myzeqese. Mbeturinat e kesaj vepre te lashte ujitese u studiuan nga arkeologet me 1949, u mesua teknika e larte e ndertimit, planimetria dhe funksionaliteti. Si ka qene ndertuar diga e Krapsit ? Ne bregun e majte te Gjanices zgjatej nje mur mbeshtetes 3 m i gjate. Ky ishte muri i diges. Diga gjarpronte mbi lume me dy harqe ne drejtime te kunderta qe ishin 90 m te gjata.

Dy ishin pjeset perberese te diges: Pjesa e poshtme apo xokolatura apo diga e ngritur mbi te. Blloqet e mureve ishin te madhesive te ndryshme te lidhuar me kllapa prej hekuri, muri i diges kishte dy kemisha, faqet e jashtme te ndertuara me blloqe kuadratike te rregullta, bashkuar me llac te cilesise se larte, kurse lidhja vertikale e blloqeve behej me pllaka hekuri, po keshtu dhe kemisha e dyte. Brenda dy kemishave ishte berthama e murit

⁸ Ne dia zona perdoret fjala **grihen**, qe mendoje se eshte e njejta, del nga shkembenjete e granitit, te perhapura kudo por vecanrisht ne Korab.

te diges, gjithashtu me gure lumi, mbeturina blloqes tjegulla dhe tulla. Te dy kemishat vinin te shkallezuara. Poshte diga ishte 15 m e gjere, kurse ne lartesi vertikale prej 5 m ishte 3 m. Mendohet qe lartesia ka qene 8m. Pjese perberese te saje qene dritaret e shkarkimit te ujrave te teperta. Largesia midis dritareve shkarkuese ishte 7 m . Kur lumi sillte shume ujra perdorej dhe nje porte shkarkuese qe ndodhej ne pjesen e siperme te diges.⁹ Ka pasur dhe nje porte tjetere qe conte uje ne kanal in kryesor. Diga e Krapsit krijonte nje ujembledhes te madh. Ne shtrirjen e tij maksimale ky rezervuar zgjatej deri 5 km.. Diga ilire e Gjanices eshte keshtu nje kryeveper inxhinierikee bujqesise ilire. Nje tjetere dige eshte zbuluar po ne lumen Gjanice ne afersi te fshatit Patos. Ajo ka qene 40 m e gjate dhe e larte 3 m de e gjere 2,5m. Kjo dige e Ppatosit duhet te jete me e vone dhe i takon mesjetes te hershme.

Fusha e Myzeqese ne dokumentet antike quhet dhe “Fusha e Ilirise. Per shkak te permbyteve te lumenjeve, ajo shpesh eshte mocalizuar ne menyre te cuditshme. Ne kete fushe ka patur nje bimesi te rralle, kuaj, si dhe buallica, nje specie gjithashtu e vecante, teper e lashte, qe per fat te keqq sot po shkon drejte zhdukjes. Por fusha e Myzeqese qe e ka marre kete emer ne Mesjete nga fisi princoror i Muzakajve, ne lashtesi ishte hambari ushqyes konkretisht it tree qyteteve te medha, Durresit, Apolonise madje dhe Vlores. Bujqesia pati disa kulte lokale shume te habitshem. Ne Apoloni qe hyjnizuar si perendi vete lumi i Vjoses qe ne shek. IV te eres sone. Ky hy eshte skulpturuare ne formen e nje plaku te shtrire sipas modelit helenistik te Hyut Nil ne Aleksandri. Njekohesisht hyu i kultit Vjosa, i quajtur Aos ka qene qene nje hy, qe ka zoteruar fushen e Myzeqese ne formen e nje mitologjie popullore, funksionale dhe ritualeske. Hyu Vjosa meriton te jete nje embleme ne cdo histori te shkruar per bujqesine ne Shqiperi ne Shekuj.



Reliev me figurë e Hyut të Pjellorisë, gjetur në Amantia, shek. III para Krishtit.

⁹ Ne termat hidroteknike te sotem eshte fjala per shkarkuesin katastrofik (I.XH)

Historia e kesaj bujqesie ne Mesjeten e Hershme ka dhe nje refe rence shkrimore te vecante. Ne shek. V te eres sone nje dijetar i quajtur Vib Sekuestri, qe ka shume gjasa te kete lindur ne qytetin e Durresit, shkroi ne latinisht nje liber, ku ben nje pershkrim gjeografik te fushave, lumenjeve, kenetave, maleve, te ultesires bregdetare te Ilirise se Jugut nga qyteti i Shkodres, duke filluar nga lumi Drin deri ne gryken e Vjoses.

Kjo deshmi letrare e klasit te pare, verteton se ne zerin Paludes (latinisht –keneta) nuk kishte ende te caktuar ne kete hapsire. Kjo gje tregon terthorazi qe zhvillimi bujqesor ende nuk kishte pesuar gjemen e kenetezimit. Te dhenat arkeologjike ne fshatin Babunje e re, ku mund te lokalizohet qyteti ilir Arnisa, fshatin Gradishte , Divjake, ne Germenje , ne Kryekuq, ne Libofshe etj. flasin per nje shumesi veglash bujqesore, qe kane nje proces perfeksionimi. Prane Lushnjes eshte fshati Plug, qe eshte emri i vegles kryesore te bujqesise.. Sipas Cabejt edhe emri Lushnje tregon nje nga format dialektore dhe te vecanta te emrit te plugut. Ne shek VI-VII te eres sone nis procesi i dyndjeve te popujve barbare, te goteve, vizigoteve, avareve dhe sllaveve. Ne kete lak kohor ndodh nje process historik i tmerrshem, qe eshte procesi i ruralizimit te jetes qytetare. Vertetohet arkeologjikisht, qe shume qendra qytetare shkaterrohen dhe humbasin funksionin e tyre. Shume qytete antike te medhenje, pothuajse vdesin, si fjala vjen Apolonia, Bylisi, Butrinti, Amantia, Antigoea etj. Por ka nje perjashtim shume te rendesishem: vazhdimesia e jetes qytetare ne kryeqendren e Shqiperise, ne Durres.

Duke qene i njohur me shtresat kulturore te Durresit mund te them me bindje, qe jo vetem nuk ka nderprerje te jetes qytetare, por ne shek. VI kemi nje ndertim madheshtor te nje rotonde ne qender te Durresit, qe ka nje funksion publik, qe tregon , por funksionin e qendres graviacionale te jetes qytetare, ku behet sinteza e kalimit nga iliret tek arberit e hershem.

Durresi eshte qyteti demiurg i etnogjenezes iliro-arberore. Keshtu ne shekujt VI-VII te eres sone shfaqet nje culture e re qe shte kultura e Komanit, ose e arbereve te hershem. Eshte procesi i formesimit te popullit shqiptar nga trashgimia e tij ilire, pa perjashtuar nje dimension trakas, por dhe te gjurmeve te perkohshme, qe lane kalimet e kelteve, te longobardeve, por dhe te sllaveve. Ne se antikiteti klasik bazohej ne modulim te qytetit Polis, mesjeta e hershme ben nje transformim te cuditshem, duke zhvendosur qendren e rendeses ne fshat. Mesjeta shqiptare nen suazen byzantine e fuqizon jeten fshatare dhe per kete sherben ne menyre te vecante, i ashtuquajtur “Nomos Gjiorgjiko”, ose Ligji Agrar, sin nje kushtetute politiko-shoqerore per mardheniet e punonjeve te tokes dhe pronareve. Ky Kod bizantin ka nje rendesi te jashtezakonshme sepse prej tij burojne disa ide te raporteve te prones bujqesore, qe jane reflektuar edhe te Kanuni i Leke Dukagjinit dhe disa kanune te tjera. Nje element gjithashtu i vecante, qe lidhet me jeten shoqerore ne kete periudhe eshte krishtrimi. Krishtrimi shebeu sin nje ideologji cliruese dhe modeluese per popujte e rinj me origjine te vjeter ne Ballkan. Krishtrimi ka ndikuar ne formesimin e arbereve te hershem qe kryesisht kane qene punonjes te tokes dhe i qe i mbante bujqesia. Kjo do te thote qe institucioni i bujqesise ka luajtur rol ne procesin e krijimit te popullit shqiptar ne kete etape. Kryesisht veshtrimi yne mbeshtetet ne permasat e te quajtures fusha ilire dhe ketu nuk duhet perjashtuar edhe fusha e Dardanise, qe ne burimet bizantine te antikitetit te vone pershkuhet “ qe ka toka te gjera te bukura dhe pjellore” . Kjo do te ishte teme me vete, por per fat te keq materialet arkeologjike per Dardanine jane ende te pakta. Por nuk mungojne burimet historike, qe flasin per pasurine e blegtorise dhe pyjeve.

Shkaterrimi i klases skllavopronareve shkaterroj dhe institucionin e skllaverise. Ne shek IX-X ne Shqiperi u perhapen mardheniet feudale. Feudalet kryesisht ushtarak, civile dhe kishtare bazoheshin ne punen e parikut, bujkrobit, qe nuk kishte prone tokesore, por punonte token e pronarit. Ne shek XI del qe shume bujkerobe kishin dhe peshkopet. Keshtu peshkopi i Gllavenices (Ballshit) kishte 40 bujkerober, peshkopi i Beratit 40 bujkerober, peshkopi i Devollit 30 bujkerober etj. Por ndodhi nje fenomen gjithashtu i rendesishem, qe pikrisht ne hapsirat shqiptare te rinise ndertimi i keshtjellave te te feudaleve, sin nje edicion i dyte i qyteteve te dikurshme antike, por jo sipas konceptit Polis. Qendrat e fortifikuara feudale jane te shumta. Ato perhapen ne te gjithe Shqiperine. Keshtu krijohen qytetet mesjetare arberore, sic eshte Sarda, Bashtova, Danja, Drishti. Keto qytete . keshtjellore bazohen mbi popullesine toke punuese.

Krijohen lidhje dhe jashte Shqiperise. Lidhjet krijohen me Raguzen, Venedikun, Ankonen, Siciline dhe Bizantin. Ne burimet arkivore, lexohen si tregtare te drithrave te Shqiperise, Balshajt, Muzakajt, Zenebishtet etj. Princi i madh Karl Topia, eksportonte grure me shumice ne Venedik dhe Raguze. Drithi keshtu behet nje pasuri, qe sherben per tregtine e jashtme dhe per fuqizimin monetar te feudaleve. Keshtu mesjeta krijon ate, qe quhet bujqesia e konceptuar jo vetem si nje pronesi feudale, por dhe ne shkembimet tregtare te domosdoshme.

Me interes per traditat antike dhe mesjetare jane dhe fjalet ne gjuhen shqipe ne terminologjine bujqesore. Fjale te tilla si drith, grure, elb, theker, te lashta dhe te vona, kallinje dhe kallez, are, bluaj, mbjelle, shije, byk dhe kashte, leme, plisa, zgjedh, shatelerroj, jane fjale kryesore te kulturave bujqesore ne Shqiperi. Por dhe fjalet molle, dardhe, shege, lepjete jane vendase, te trashguara nga ilirishtja, si dhe fjalet kumbull, draper, laker, etj. Kto deshmi gjuhesore kane rendesi kolosale per te treguar autoktonine e bujqesise ne Shqiperi. Tezat qe sllavet e mundesuan bujqesine shqiptare duhen perkthyer ne te kunderten, eshte kultura bujqesore iliro-shqiptare, qe ka mbijetuar dhe madje asimiloi grupe slave, qe vershuan ne Shqiperi. Per autoktonine e shqiptareve ne institucionin e bujqesise kane rendesi vendimtare disa kulte dhe mitologji pagane vendase, qe lidhen jo vetem me procesin bujqesor, por sidomos ne hyjnzimin e veglave bujqesore. Mbledhja e miteve dhe riteve te besimeve pagane per parmenden ne Shqiperi, tregojne ne menyre vertikale vijimesine. Per parmenden qe nga epoka ilire kane ekzistuar disa mite jashtezakonisht interesante. I cuditsHEME dhe trondites eshte miti, qe kur ka bubullima dhe stuhi ne qiell, thuhet se lufton dragoj me kucedren, lufte qe perben nje kozmogoni te tejlashte ilire. Dragoj si force e se mires e sulmon Kucedren, simbolin e se keqes, pikrisht me parmende. Imagjinoni nje beteje qiellore, ku dragoj e mund kucedren me armen hyjnore te parmendes. Parmenda keshtu, eshte per bujqit ilir me e plotefuqishme se rrufeja e Zeusit. Ne disa rrethina etnografike te Shqiperise se Jugut grupi i yjeve, qe emrohet Arusha e madhe, quhet dhe “Yllesia e Parmendes”, Grafikisht kjo yllesia te kujton vertete formen e parmendes, qe e kemi gjetur te skicuar ne monumente dhe pitosa. Keto legjenda iliro-shqiptare kane mbijetuar dhe ne katundet arbereshe te Italise si ne San Demetro Korone, ne Maki etj.

Nje legjende ne fshatin Macukull te Matit, thuhet se populli u largua nga ky vend, per shkak te nje perndjekje. Para ikjes fshehen nje parmende te arte nen dhe ne fshatin (lagje I. Xh) Curkaj. Legjenda tregon se per parmenden e arte u flijua dhe nje femije. Deri vone besohej se parmenda e arte mund te gjendej po te derdhej nje thes me miell rreth e rrotull vendit ku ajo ishte goposur.

Nje legjende origjinale dhe e hatashme tek shqiptaret, eshte ajo e yllsise qe quhet “Kashta e Kumtrit”. Behet fjale per per kashten e drithit te nje leme, qe fluturoj ne qiell dhe u yjezua.. te gjitha keto flasin per kozmogoni dhe nje astronomi te konceptuar dhe te konsenuar nga vendasit, punonjes te tokes ne Shqiperi. Nje mrekulli piktorike e fillimit te shek. XVIII eshte afresku i David Selenices ne Kishen e Shen Nikolles ne Voskopoje, qe quhet Farembjellesi.¹⁰ Afresku i Farembjellsit ne ne nje fare menyre mund te konsiderohet nje embleme e antropomorfizuar e krishtere dhe njekoheisist pagane e historise se lashte te bujqeve ilire shqiptare.

Kjo qe nga historia ne Mesjete strukturon institucionin e bujqesise si nje nga substancat kryesore te qytetrimet iliro-shqiptar

Me poshte prezantohet shume shkurtimisht sfondi i Historise te Bujqesise mbareboterore , me qellimin as me shume dhe as me pak qe lexuesi te beje referencen dhe diferencen kohore te zhvillimit. (I.XH)

VERSUS HISTORISE MBAREBOTERORE TE BUJQESISE NEPER SHEKUJ DHE MIJE VJECARE



Ne zonat me pjellore sic ishin ato te Azise Perndimore, Egjyptit dhe te Indise qe shume heret ka ekzistuar nxitja per kultivimin e bimeve qe me para konsideroheshin te egra.

¹⁰ Emertimi Farembjellesi, ne vend te Farehedhesit qe emertohet afresku eshte nje rivitalizim i vlerave te kesaj vepre unikale.

Rajone disi te vecuara te bujqesise gjendeshin dhe ne Kinen Jugore ne Guinene e Re dhe shume rajone te Amerikes.

Tete bimet e para te ashtuquajtuara themelues te Neolitikut kane qene : Disa forma te grurit, okra (*Triticum monococum*), tepa (*Triticum diccocum*), me pas elbi disa rrjeshtash, ose elbi distik, bizelet dhe , thjertzat, qiqlra, (*Cicer arietinum*), Urofi, (*Lathyrus montanus*) dhe Lini (*Linum ussitasimum*), Flax, ne angl..

Duke filluar nga viet 7 000 p.e.s. , bujqesia ka mbriritur ne Egjypt dhe nenkontinenti Indian nisi me kultivimin e grurit dhe te elbit, gje qe vertetohet nga zbulimet ne Balochistan, (Sot Pakistani). Duke vazhduar pas vitit 6000, BC, ferma ne nivele mesatare ndodheshin ne forme rripash pergjate brigjeve te Nilit.

Akoma ujitja nuk kishte marre formen dhe perkrahjen nga kjo bujqesi e athershme.. Kesaj periudhe i perkasin dhe zhvillimet ne Lindjen e Larget me oriz, thuajse me shume se me grure, si bime baze, (staple ne angl.) te komplementuara me prodhimet nga deti.

Nga vitet 5000 p.e.s. popujt Sumerian zhvilluan bazen e bujqesise, qe do te thote kultivimin intensiv te tokes, akoma monokulture, ujitje te organizuar etj. sigurisht pergjate shtrateve te lumenjeve, Shat al-Arab, qe nga gjiri Persik deri ne bashkimin e Tigrit dhe te Euphratit. Pas domestikimit, zbutjes tashme te kafsheve, barinjte do te bashkoheshin me fermeret, bujqit qe garantonin nje jete ose sedentare apo gjysem nomadike. Misri, manioku, si dhe frutrenjoret fillimisht jane domestikuar ne Amerike te pakten qe nga viti 5200 p.e.s.

Patatja, domatja, speci, kungulli sidhe disa variete te fasules, duhani si dhe shume bime te tjera kishin marre nje zhvillim ne Amerike lidhur me me nje perhapje shume te madhe te tarracimeve ne pjesen me te madhe te Andeve.

Greket dhe Romaket ben perpjekje per zhvillimin e bujqesise, por jo shume te rendesishme ne krahasim me ato qe ben popujt Summerian¹¹. Greket, sidomos ato te Jugut duhej te perballoshin nje bujqesim ne toka te shkreta dhe megjithate ja arriten. Ndersa Romaket ishin me shume te interesuar per bimet qe lidheshin me tregun.

Ne kohen e eksplorimit European do te kemi domestikimin e Kokoas, apo te gjelit te detit (Edhe sot festohet ne fund te tetorit festa e Halloween-it. Po keshtu mund te shtojme domestikimin e lulediellit, duhanit, shume varieteve te kungullit, panjes sheqeroze, luleshtrydheve , bime te familjes kenopodiaceae (te panxharit).

Ne Mesjete, fermeret ne Afriken e Veriut, Lindjen e Aferme dhe ne Europe, mundesuan perfshirjen e teknologjive te tilla sic ishte sistemi i ujitjes, digave ,mjeteve per lartesimin e ujit. Kjo dhe ne sfondin e nje rotacioni, qarkullimi, me tre fusha.

Shenim ;Kjo pjese ka per qellim vendosjen e historise te bujqesise, apo lashtesise, sic prezantohet nga autori, ne sfondin e historise boterore te bujqesise. Nuk eshte e veshtire te diktohet lashtesia e kesaj bujqesie shqiptare te pakten ndaj tablllos te historise Europine te saj, ku prevalon kjo tradite.

Pergatitur me shenime nga Idriz Xhomara, Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes te Konsumatorit

¹¹ Paraardhesit e Babilonasve , popull semitik , hebrej (I.XH)